

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Nebojša Boričić anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të kërkuarit për ekstradim R. S., për shkak të veprës penale trafikim të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotropike nga neni 178.7 dhe 89 të Kodit Penal Sllovak, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të kërkuarit për ekstradim, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda NJN.nr.69/2016 të datës 27.01.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.230/17 të datës 02.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.02.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të kërkuarit për ekstradim R. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda NJN.nr.69/2016 të datës 27.01.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.230/17 të datës 02.02.2017.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin NJN.nr.69/2016 të datës 27.01.2017, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda dhe ka lejuar ekstradimin e të kërkuarit për ekstradim R. S., i cili është dënuar për shkak të veprës penale trafikim të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotropike nga neni 178.7 dhe 89 të Kodit Penal Sllovak, e cila vepër është e sanksionuar me dispozitat ligjore të nenit 230 par.1 të KPK e ndëshkueshme me dispozitat e nenit 274 të KPK, për vazhdimin e procedurës së mbajtjes së dënimit në shtetin e Republikës së Sllovakisë. Të dënuarit do t'i llogaritet edhe koha në paraburgim prej datës 16.10.2016, e tutje deri në ndonjë vendim tjetër gjyqësorë. Në emër të shpenzimeve të procedurës së ekstradimit i kërkuari për ekstradim është obliguar të paguajë paushalin gjyqësor në shumë prej 50€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.230/17 e datës 02.02.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësve të të kërkuarit për ekstradim dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

*Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.*

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të kërkuarit për ekstradim R. S., av. B. Q. dhe av. L. Q. - I., për shkak të shkeljes së ligjit penal te nenit 385 par.1 nënpar.1.4, shkeljeve esenciale të Ligjit të Procedurës Penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.7, 1.7 dhe 1.12 dhe nenit 415 par.1 nënpar.1.1, 1.3 dhe 1.4 dhe se aktvendimet e atakuara janë në kundërshtim me nenin 178 par.3 dhe 4, nenin 18 par.2 nënpar.2.4, nenin 23 par.7 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar këtë kërkesë dhe t'i anulojë aktvendimet e lartëcekura dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësit theksojnë se kryesisht aktvendimi i shkallës së dytë nuk përmbanë arsyetim profesional, është i magët, abstrakt dhe nuk ka të bëjë me realitetin e rastit konkret, se kjo gjykatë e ka bërë këtë shkelje me qëllim dhe pa asnjë lloj arsytimi për të mos i evidentuar shkeljet e bëra nga Gjykata Themelore në Ferizaj, se i kërkuari për ekstradim R. nga Gjykata e shtetit Sllovak është gjykuar dhe dënuar në mungesë, se gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancë publike me datën 27.01.2017 në të cilën nuk kanë qenë prezent as i kërkuari për ekstradim e as mbrojtësi dhe nuk iu është dhënë mundësia të përballen me Prokurorin lidhur me vërtetësin dhe bazën ligjore të shkresave të lëndës dhe se Gjykata e Apelit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural.

*Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.8/17 e datës 21.02.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të kërkuarit për ekstradim të refuzohet si e pabazuar.

*Gjetjet e Gjykatës Supreme*

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo - juridike nga shkresat e lëndës rezulton se personi i kërkuar për ekstradim R. S. kërkohet nga autoritetet e Republikës Sllovake ngase me aktgjykimin e Gjykatës Rajonale në Bratisllavë nr.6T/2/03 të datës 03.02.2011 i njejtë është shpallur fajtor për veprën penale të lartëcekur dhe iu është caktuar dënimi me burg prej 10 (dhjetë) vjet. Sa i përket pretendimit të mbrojtësve se gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancë publike pa prezencën e tyre me datën

27.01.2017 është e paqëndrueshme ngase me këtë datë kjo gjykatë me aktvendim ka aprovuar kërkesën e prokurorit për ekstradim duke e bërë një gabim teknik në preambulën e aktvendimit në të cilën gabimisht ka shkruar *seancë publike të mbajtur më dt.27.01.2017* të cilin gabim e ka evituar me një aktvendim plotësues NJN.nr.69/2016 të datës 14.02.2017 duke e përmirësuar *në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më dt.27.01.2017*, ndërsa sa i përket pretendimit se nuk iu është dhënë mundësia që të përballen me prokurorin është e pabazuar ngase sipas procesverbalit të seancës ndëgjimore për ekstradim të datës 24.11.2016 kanë qenë të pranishëm si i kërkuar për ekstradim R. S. ashtu edhe mbrojtësja e tij av. L. Q.-I., të cilët e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimit se i kërkuari është gjykuar në mungesë sipas shkresave të lëndës vërtetohet se i njejtë është njoftuar përmes përfaqësuesit të autorizuar në bazë të ligjit të shtetit kërkuar, ndërsa sipas nenit 17 par.4 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, Republika Sllovaqe ka obligim që të gjykojë, nëse kërkon, t'ia mundësojë të drejtën për rigjykim me qëllim që të sigurohen të drejtat minimale të mbrojtjes.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.31/2017, më datë 22.02.2017

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta